


|                                                                |        |          |          |
|----------------------------------------------------------------|--------|----------|----------|
| REPUBLIC OF KOSOVO<br>REPUBLIC OF KOSOVO<br>REPUBLIC OF KOSOVO |        |          |          |
| 23 03 2020                                                     |        |          |          |
| RECEIVED                                                       |        |          |          |
| ask. orig.                                                     | Numri  | Shkruar  | Vlera    |
| Reg. Jostinica                                                 | Proj.  | Prilog   | Vrednost |
| Reg. Unit                                                      | Number | Appendix | Value    |
| 01                                                             | 351    | 16185    | 5        |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA SUHAREKË  
KONTRATË

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala , zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar ne PMK me aktvendim te ZKA-se (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"ENERGIE"SH.P.K, Brigada 123, Suhareke, 23000, Kosovë me NRB: 810197211 të cilën e përfaqëson Samir Berisha (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Fondi emergjent - Furnizim me pako ushqimore dhe hixhienike  
me numër prokurimit: 624-20-910-1-2-5-624 020 014 125

**Neni 1 Lënda**

Lënda e kontratës do të jetë dërgesa nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim: **Fondi emergjent - Furnizim me pako ushqimore dhe hixhienik** , sipas specifikimeve teknike te dhena në dosje të tenderit.

1.2 E.O është i obliguar te bashkëpunoj me menagjerin e kontratës te Autoritetit Kontraktues dhe zyrën e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menagjerin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzimin e mallrave është 5 dite nga data e nenshkrimit te kontrates. Afati per fillimin e furnizimit 1 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë siç është cekur ne dosje: **Komuna Suharekë** .

2.3 Inkotermi<sup>1</sup> i zbatueshëm do të jetë.

**Neni 3 Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

**Neni 4 Çmimi**

4.1 **Çmimi total i furnizimeve me pako ushqimore 19.728,00 nëntëmbëdhjetë mijë shtatëqind e nje zete e tetë euro.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4.5 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagësen në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi për pranim të mallit dhe menagjeri i kontratës, në llogarinë bankare të OE: BE Nr:

**Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

6.5 Kontrata menaxhohet nga njësia e kërkesës Drejtoria e Bujqësisë dhe Menaxheri i percaktuar me PMK<sup>3</sup> dhe vendim të ZKA-së<sup>4</sup>.

6.6 Menaxheri i kontratës i është i obliguar që pas plotësimit dhe nënshkrimit të PMK-së me OE të njëjtin mbrenda dy ditë ta dorëzojë në ZP.

6.7 Numri i kontaktit me OE është:

**Për Autoritetin Kontraktues:**

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Mustafë Buzhala                                                                     |
| Pozita:     | Zyrtar i zyrës së Prokurimit                                                        |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 23.03.2020                                                                          |
| Vula:       | vv                                                                                  |



**Për Furnizuesin:**

|            |                                                                                       |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:      | Samir Berisha                                                                         |
| Pozita:    | Përfaqësues                                                                           |
| Nënshkrimi |  |
| Data:      | 23.03.2020                                                                            |
| Vula:      | vv                                                                                    |



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

<sup>3</sup> PMK Plani i Menaxhimit të Kontratës

<sup>4</sup> ZKA Zyrtari Kryesor Administrativ



**PJESA III E KONTRATES      KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-------------------------------------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                  | Nr. Nenit | <b>Fondi emergjent - Furnzim me pako ushqimore dhe hixhienike me numër prokurimit: 624-20-910-1-2-5- 624 020 014 125</b>                                                                                                                                                                                                                                    |
| Ligji zbatueshëm dhe gjuha          | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                  |
|                                     | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Siguria ekzekutimit                 | 9.1       | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Sigurimi                            | 10.1      | Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Programi ekzekutimit                | 11        | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Tatimet dhe marrëveshjet doganore   | 12.1      | DDP (Delivery Duty Paid)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Patentat dhe licencat               | 13.1      | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Cilësia furnizimeve                 | 18.2      | Autoriteti Kontraktues do te refuzoje çdo dergese te materilait i cili deshton ne permbushjen e specifikimeve minimale te cilesise te percaktuara ne specifikimin teknik.                                                                                                                                                                                   |
| Inspektimi dhe testimi              | 19.2      | <b>Autoriteti Kontraktues do te caktojë menaxherin e kontratës i cili është nga Njesia e kerkeses dhe nje mbikqyres/Komision i cili do te beje pranimin e mallrave.</b><br><br>Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë furnizimet e kryera të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e furnizimeve dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit. |

|                                                   |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Pagesa                                            | 20.1 | Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorezuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Dorëzimi                                          | 21.3 | <p>Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.</p> <p><b>Dërgesa:</b></p> <p>Dërgesat do të bëhet brenda 3 ditëve pas marrjes së “urdhër blerjes” nga ana e Furnizuesit.</p> <p>Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).</p> |
| Obligimet e garancionit                           | 24.1 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|                                                   | 24.5 | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Shërbimet pas shitjes                             | 25.1 | N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 31.2 | <b>Zyra e Prokurimit Komuna Suhareke.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 32.1 | <p>a a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p>                                                                                                                                                                                                                         |

# PERSHKRIMI I CMIMEVE

## Përbërja e pakos ushqimore dhe higjienike

| Nr | Përshkrimi i materialit | Sasia  |
|----|-------------------------|--------|
| 1  | Miell                   | 50 kg  |
| 2  | Vaj ushqimor            | 5 lit. |
| 3  | Oriz                    | 2 kg   |
| 4  | Sheqer                  | 5 kg   |
| 5  | Pasta                   | 2 kg   |
| 6  | Veget                   | ½ kg   |
| 7  | Krip                    | 1 kg   |
| 8  | Qepë                    | 5 kg   |
| 9  | Patate                  | 10 kg  |
| 1  | Detergjent              | 6 kg   |
| 2  | Sapun                   | 5 cope |
| 3  | Shampon                 | 3 lit. |

| Pershkrimi                                                       | SASIA | çmimi  | SHUMA      |
|------------------------------------------------------------------|-------|--------|------------|
| Pako ushqimore dhee hixhienike sipas pershkrimit te sipershenuar | 300   | 65.76€ | 19,728.00€ |

## DORËZUAR NGA:

|                                    |                      |
|------------------------------------|----------------------|
| IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK |                      |
| EMRI I KOMPANISE                   | "ENERGIE" Sh.p.k     |
| ADRESA E PLOTE                     | Briq. 123 - Suharekë |
| PERFAQESUAR NGA:                   |                      |
| EMRI                               | Samin Berisha        |
| POZITA                             | Drejtor              |
| NENSHKRIMI                         | <i>[Signature]</i>   |
| DATA                               | 20.03.2020           |
| VULA                               |                      |

